



REPUBLIKA E SHQIPËRISE
BASHKIA E TIRANËS
QENDRA EKONOMIKE E ZHVILLIMIT DHE EDUKIMIT TË FËMIJËVE

Nr. _____ prot.

Tiranë, më ____, ____, 2018

Formular i njoftimit të fituesit

Data 28/09/2018

Për: Operatorin Ekonomik **“W. Center”** Sh.p.k.

Adresa : Lagjia 8 Shkurti, Pallati 2 katesh , Perball "Gjimnazit Perikli Ikonomi", Fier.

Procedura e prokurimit: **Kërkesë për propozim.**

Numri i Referencës për Procedurën: Blerje Materiale Pastrimi - **REF-67331-05-07-2018.**

Përshkrim i shkurtër i kontratës: Objekti “Blerje Materiale Pastrimi” me fond limit 4 889 417 (katër milion e tetëqind e tetëdhjetë e nëntë mijë e katërqind e shtatëmbëdhjetë) lekë pa T.V.SH. Fondi i mësipërm nuk i përfshin të gjitha detyrimet fiskale si dhe T.V.SH-në.

Publikime të mëparshme: **Buletini i Njoftimeve Publike Nr. 19, Datë 14 Maj 2018**

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit: çmimi më i ulët X, oferta ekonomikisht më e favorshme

Njoftojme se, kanë qenë pjesëmarrës në procedurë këta ofertues me vlerat përkatëse të ofruara:

1. Shoqëria **“ATLANTIK 3”** Sh.p.k

K22218003V

Emri i plotë i shoqërisë

numri i NIPT-it

Vlera e ofertës ekonomike të paraqitur është 4 398 250 lekë pa T.V.SH.

2. **“Denisa Beshaj”** (Person Fizik)

L41904011K

Emri i plotë i shoqërisë

numri i NIPT-it

Vlera e ofertës ekonomike të paraqitur është 4 249 100 lekë pa T.V.SH.

3. Shoqëria **“DIMEX”** Sh.p.k

J61805519O

Emri i plotë i shoqërisë

numri i NIPT-it

Vlera e ofertës ekonomike të paraqitur është 2 850 700 lekë pa T.V.SH.

4. Shoqëria **“EURO MEGA 2010”** Sh.p.k

K91624505A

___ Adresa: Rruga “Barrikadave”, Kodi Postar 1001, tel.: +355 42222991, web: femijetetiranes.al, email: femijet@tirana.al ___

Emri i plotë i shoqërisë

numri i NIPT-it

Vlera e ofertës ekonomike të paraqitur është 2 821 900 lekë pa T.V.SH.

5. Shoqëria “**S I G I**” Sh.p.k

K42201008B

Emri i plotë i shoqërisë

numri i NIPT-it

Vlera e ofertës ekonomike të paraqitur është 4 540 090 lekë pa T.V.SH.

6. Shoqëria “**Shpiragu**” Sh.p.k

J81503005U

Emri i plotë i shoqërisë

numri i NIPT-it

Vlera e ofertës ekonomike të paraqitur është 4 470 260 lekë pa T.V.SH.

7. Shoqëria “**W. CENTER**” Sh.p.k

K63029402A

Emri i plotë i shoqërisë

numri i NIPT-it

Vlera e ofertës ekonomike të paraqitur është 4 559 550 lekë pa T.V.SH.

Janë skualifikuar ofertuesit e mëposhtëm:

1. “Atlanik 3” shpk

1.1 Kriteret e veçanta pika 2.3.4, operatori ekonomik nuk ka dorëzuar mostrat sipas specifikimeve teknike të autoritetit kontraktor për artikujt e kërkuar:

1.1.1 Artikulli “Detergjentë rrobash”

- Data e prodhimit 29.05.2017
- Data e skadencës mungon.

Në specifikimet teknike për këtë artikull, është kërkuar që: *Në qoftë se produkti përmban vetëm datën e prodhimit, produkti duhet të jetë prodhim i vitit 2018, ndërsa produkti i paraqitur si mostër e ka datën e prodhimit 29.05.2017.*

Mostra e paraqitur, në etiketën e vendosur nga OE nuk ka datën e hapjes së tenderit, por ka datën 20.03.2018

Në skedën teknike të sigurisë së paraqitur në sistemin elektronik, vërehet se kjo skedë është për produktin e markës “Kalyon” dhe nuk përputhet me produktin e paraqitur si mostër i cili është i markës “Merix”.

Nga verifikimi i rezultateve të treguesve të analizave të kryera në ISHTI, vërehet se ka ndryshime në parametrat e kërkuara në specifikimet teknike.

Këto ndryshime ndikojnë në mënyrë të ndjeshme në cilësinë e produktit, konkretisht:

- “Përmbajtja e lagështisë” është shumë e lartë,
- “Aftësia shkumuese” është shumë e vogël
- “Përmbajtja e perboratit të natriumit” është shumë herë më e vogël se ajo që kërkohet.

Ky artikull zë një peshë specifike të madhe në preventivin e materialeve të pastrimit dhe mangësitë që janë konstatuar më sipër në mostrën e paraqitur:

- a) Mos plotësimi në masë të konsiderueshme i parametrave më të rëndësishëm të kërkuar në disa prej treguesve të raport analizës,
- b) Mungesa e skedës teknike janë arsye shumë të rëndësishme dhe referuar kësaj, mostra e paraqitur nuk i plotëson kërkesat e përcaktuara në dokumentat e tenderit.

1.1.2 Artikulli “Qese mbeturinash”

- Mostra e paraqitur është e markës tregëtare “Eco Respect”, me përmasa 50x60 cm. Përmasat e mostrës së paraqitur nuk janë sipas specifikimeve teknike të kërkuara 70cm x 100cm.
- Mostra e paraqitur nuk e përmban etiketimin e OE me të dhënat: mostër “emri i artikullit”, datën e zhvillimit të tenderit, emrin e ofertuesit, nënshkrimin dhe vulën e Operatorit Ekonomik.
- Vërehet se ka ndryshime në parametrat e kërkuara në specifikimet teknike të cilat ndikojnë ndjeshëm në cilësinë e produktit,

1.1.3 Artikulli “Peceta pastrimi”

- Përmasat e mostrës së paraqitur janë 32x32 cm. Përmasat e mostrës së paraqitur nuk janë sipas specifikimeve teknike të kërkuara 38cm x 40 cm
- Mostra e paraqitur nuk e përmban etiketimin e OE me të dhënat: mostër “emri i artikullit”, datën e zhvillimit të tenderit, emrin e ofertuesit, nënshkrimin dhe vulën e Operatorit Ekonomik.
- Vërehet se ka ndryshime në parametrat e kërkuara në specifikimet teknike të cilat ndikojnë ndjeshëm në cilësinë e produktit.

1.1.4 Artikulli “Kova”

- Është material plastik i fortë dhe pesha totale e saj së bashku me shtrydhësen është 400 gr, ndërkohë që në specifikimet teknike të kërkuara për këtë produkt, pesha specifike e kovës duhet të jetë jo më pak se 540 gr.
- Mostra e paraqitur nuk e përmban etiketimin e OE me të dhënat: mostër “emri i artikullit”, datën e zhvillimit të tenderit, emrin e ofertuesit, nënshkrimin dhe vulën e Operatorit Ekonomik.
- Për arsye se pesha specifike e kovës së paraqitur si mostër, nuk është në parametrat e kërkuar, mostra nuk është konform specifikimeve teknike të kërkuara.

1.1.5 Artikulli “Shtupa me bisht”

- Shtupa është me fibra viskoze tekstili, pambuku me gjatësi 24 cm, ndërkohë që në specifikimet teknike kërkohet 32 cm.
- Mostra e paraqitur nuk ka fare etiketë të OE sipas kërkesës së përcaktuar në dokumentat e tenderit.

1.1.6 Artikulli “Solucion për pastrimin e sobave”

- Mostra e paraqitur, në etiketën e vendosur nga OE nuk ka datën e hapjes së tenderit sikurse kërkohet në dokumentat e tenderit.

Në Raport Analizën e paraqitur duket qartazi që produkti që është analizuar, është në shishe

plastike 750 ml, ndërsa mostra e paraqitur është shishe plastike 500 ml. Kjo mospërputhje tregon se Raport Analiza e kryer nuk i përket artikullit të paraqitur si mostër.

Për arsye se Raport Analiza e paraqitur nuk përputhet me artikullin e paraqitur, mostra nuk plotëson specifikimet teknike të kërkuara.

Oferta ekonomike 4 398 250 lekë pa T.V.SH

2. “Denisa Beshaj” (Person Fizik)

- 2.1 Kriteret e veçanta pika 2.1.1, operatori ekonomik nuk ka paraqitur dokumentacion që vërteton disponimin e QKL.
- 2.2 Kriteret e veçanta pika 2.1.2, operatori ekonomik nuk ka paraqitur dokumentacion që vërteton shlyerjen e taksave vendore për vitet 2015, 2016, 2017. Ka paraqitur dokumentacion për shlyerjen e taksave vendore të vitit 2018, vit i cili nuk është kërkuar në kriteret e veçanta të kësaj procedure.
- 2.3 Kriteret e veçanta pika 2.3.1 , operatori ekonomik nuk ka paraqitur dokumentacion që vërteton përmbushjen e vlerës prej 40% nga furnizimet e mëparshme të ngjashme. Operatori ekonomik ka paraqitur disa fatura ku vlera e përlllogaritur e tyre nuk e kap vlerën e kërkuar nga ky kriter. Fatura Nr.3 e datës 11.08.2016 dhe fatura Nr.40 e datës 30.12.2016, nuk kanë artikuj, objekt i këtij prokurimi dhe si të tilla nuk përlllogoriten si furnizime të ngjashme.
- 2.4 Kriteret e veçanta pika 2.3.2, operatori ekonomik nuk ka paraqitur dokumentacion që vërteton posedimin në pronësi/me qira të 1 mjeti transporti i cili do të shërbejë për transportin e materialeve të pastrimit.
- 2.5 Kriteret e veçanta pika 2.3.3 operatori ekonomik nuk ka paraqitur dokumentacion që vërteton përmbushjen e këtij kriteri.
- 2.6 Kriteret e veçanta pika 2.3.4, operatori ekonomik nuk ka paraqitur mostrat pranë QEZHEF, në ditën dhe orën e hapjes së ofertave.

Oferta ekonomike 4 249 100 lekë pa T.V.SH.

3. “Dimex” shpk

- 3.1 Kriteret e veçanta pika 2.3.1, operatori ekonomik nuk ka paraqitur dokumentacion të saktë që vërteton përmbushjen e vlerës prej 40% nga furnizimet e mëparshme të ngjashme. Dokumentacioni i paraqitur rezulton të jetë jo korrekt; - kontratë me Nr.617/4 Prot, datë 03.10.2014, realizimi i saj është në vitin 2014 (referuar dhe vërtetimit Nr.199 Prot, datë 09.12.2016), vit i cili është jashtë afateve ligjore që duhet për plotësimin e këtij kriteri.

- Operatori ekonomik disa nga faturat e paraqitura i ka të paqarta dhe të palexueshme në elementet që kërkon kriteri për kapacitetin teknik(datat, shumatat, artikujt dhe sasitë). Paraqitja e një dokumentacioni të qartë dhe të lexueshëm në sistem, është detyrim i operatorit ekonomik. Këto fatura nuk mund përfshihen në përlllogaritje.

Nga përlllogaritja totale e dokumentacionit të lexueshëm vlera e tyre nuk e kap vlerën e kërkuar nga ky kriter.

Oferta ekonomike 2 850 700 lekë pa T.V.SH.

4. “Euro Mega 2010” shpk

- 4.1 Kriteret e veçanta pika 2.3.3, operatori ekonomik nuk ka paraqitur në sistem dokumentacionin që vërteton përmbushjen e këtij kriteri.
- 4.2 Kriteret e veçanta pika 2.3.4, operatori ekonomik nuk ka paraqitur mostrat pranë QEZHEF, në ditën dhe orën e hapjes së ofertave.

Oferta ekonomike 2 821 900 lekë pa T.V.SH.

KVO vendosi të kualifikojë operatorët ekonomikë si më poshtë:

1. **“S I G I”** Sh.p.k me ofertë ekonomike 4 540 090 lekë pa T.V.SH.
2. **“Shpiragu”** Sh.p.k me ofertë ekonomike 4 470 260 lekë pa T.V.SH.
3. **“W.Center”** Sh.p.k me ofertë ekonomike 4 559 550 lekë pa T.V.SH.

Rezultojnë oferta anomalisht të ulëta.

1. **“Dimex”** Sh.p.k me ofertë ekonomike 2 850 700 lekë pa T.V.SH.
2. **“Euro Mega 2010”** Sh.p.k me ofertë ekonomike 2 821 900 lekë pa T.V.SH.

Përsa mësipër njoftimi i klasifikimit u publikua më datë 24.05.2018.

Në afatet ligjore të parashikuara, ka pasur ankesa në Autoritetin Kontraktor nga operatorët ekonomik **“W.Center”** Sh.p.k dhe **“Dimex”** Sh.p.k.

Operatori ekonomik **“W.Center”** Sh.p.k ka paraqitur ankesë në KPP.

Më datë 07.09.2018, me **Vendimin Nr.588/2018 KPP**, ka anuluar kualifikimin e operatorëve ekonomik **“S I G I”** Sh.p.k dhe **“Shpiragu”** Sh.p.k.

Më datë 17.09.2018 është bërë rivlerësimi në sistem.

Më datë 19.09.2018 me **Vendimin Nr. 588/3/2018 KPP**, ka vendosur të heq pezullimin e procedurës së prokurimit me Nr. **REF-67331-05-07-2018** me objekt **“Blerje Materiale Pastrimi”**, me fond limit 4 889 417 lekë pa TVSH, zhvilluar më datë 21.05.2018, nga autoriteti kontraktor Qendra Ekonomike e Zhvillimit dhe Edukimit të Fëmijëve, Bashkia Tiranë.

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë Operatorin Ekonomik: **“W. CENTER”** sh.p.k, me adresë kryesore: Lagjia 8 Shkurti, Pallati 2 katësh , Përball "Gjimnazit Perikli Ikonomi", Fier, se oferta e paraqitur, prej 4 559 550 (katër milion e pesëqind e pesëdhjetë e nëntë mijë e pesëqind e pesëdhjetë) lekë pa T.V.SH dhe 5 471 460 (pesë milion katërqind e shtatëdhjetë e një mijë e katërqind e gjashtëdhjetë) lekë me T.V.SH është identifikuar si oferta e suksesshme.

Rrjedhimisht, jeni të lutur të depozitoni pranë **Autoritetit Kontraktor, Qendra Ekonomike e Zhvillimit dhe Edukimit të Fëmijëve**, me adresë Rr. “ Barrikadave ”, Çerdhja Nr. 1, Tiranë,

kopjen e nënshkruar te formularit te kontratës dhe të sigurimit të kontratës, siç parashikohet në dokumentat e tenderit, brenda 60 (gjashtëdhjetë) ditëve nga dita e marrjes/publikimit të këtij njoftimi.

Në rast se nuk pajtoheni me këtë kërkesë, ose tërhiqeni nga nënshkrimi i kontratës, do të konfiskohet sigurimi i ofertës suaj (nëse është kërkuar), siç parashikohet në nenin 58 të Ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar.

Klasifikimi është bërë në datë 24.05.2018.

Riklasifikimi është bërë në datë 17.09.2018.

Titullari i Autoritetit Kontraktor

Zhaneta BEQIRI

